

Familja është e shenjtë, si mund ta mbrojmë atë?



15 Maji, si dita ndërkombëtare e familjes, na ndihmon të bëjmë pak një ndalim nga vrapimi i përditshmërisë dhe të mendojmë më shumë për familjen, të cilën me të drejtë mund ta quajmë “qelizën” e shoqërisë njerëzore, ose siç e quan shkrimtari i madh Viktor Hygo, “skeleti i shoqërisë”. Familja sot po përballet me shumë probleme të kushtëzuara nga proceset e vrullshme sociale, ekonomike dhe demografike në të gjithë botën.

Termi familje vjen nga fjala latine “famulus” që do të thotë “rob i shtëpisë” ose “shërbëtor”. Për romakët këta ishin njerëzit e shtëpisë që kishin midis tyre një lidhje prej martese, lindje ose adoptimi, të cilët jetojnë në pronë të përbashkët dhe i shërbejnë njëri-tjetrit.

Në nenin 16(3) të deklaratës për të drejtat e njeriut përcaktohet se: “Familja është grupi natyral dhe kryesor në shoqëri dhe ka të drejtë për mbrojtjen nga shoqëria dhe shteti”.

Zyra e regjistrimit të përgjithshëm së SHBA-së e përcakton familjen si “dy apo më

shumë persona që lidhen nga lindja, martesë ose adoptimi, të cilët jetojnë së bashku”.

Kodi Civil i familjes së Republikës së Shqipërisë thotë në Nenin 1: “Martesë si bashkjetesë ligjore, mbështetet në barazinë morale dhe juridike të bashkshortëve në ndjenjën e dashurisë, respektit dhe të mirëkuptimit reciprok, si bazë e unitetit të familjes.” Martesë dhe familja mbrohen veçanërisht nga shteti.

Pra koncepti i përgjithshëm klasik na tregon se familja është një institucion biosocial, i përbërë nga dy persona (burrë dhe grua) jo të një gjaku, dhe pjesëtarë të këtij grupi bëhen edhe fëmijët e lindur ose të adoptuar.

Por ajo që vihet re në kohët e fundit është se ka individë, shoqata, grupe interesi, madje dhe qeveri të imponuara me forcën e ligjit, të cilët bëjnë përpjekje për ta ndryshuar konceptin natyral të familjes. Në disa vende të Europës, si p.sh. në Francë, ku si vazhdim i ligjit mbi barazinë ligjore të martesave në çiftet heteroseksuale dhe atyre homoseksuale, u votua një ligj i ri me të cilin heqin nga përdorimi termat “nënë” dhe “baba” dhe i zëvendësojnë me termat “prindi 1” dhe “prindi 2” .

Mbi qeverinë dhe parlamentin e Shqipërisë, është bërë gjithashtu presion që të ndryshohet kodi civil në lidhje me martesën, ku sipas Nenit 7 cilësohet “Martesë mund të lidhet nëpërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç”, ku të mos përcaktohet me gjinia e personave. Fatmirësisht, nga presioni i ushtruar i shoqërisë shqiptare, që tradicionalisht respekton dhe nderon familjen në konceptin e saj klasik, burrë dhe grua, këto nisma nuk janë aprovuar.

Shkaqet që familja sot është bërë kaq e brishtë moralisht, lehtësisht e thyeshme me divorc dhe e tjetërsuar nga perversioni, nuk janë thjesht sociale, ekonomike apo demografike, por sekularizim gjithnjë e më shumë i shoqërisë njerëzore.

Në vendet me një qytetërim sekular, i ndërtuar mbi moralin e krishterë, ka një tendencë në rritje drejt një “lirie” mendimi që çon në gnosticizëm dhe ateizëm, që mohon ekzistencën e një Zoti personal të moralshëm, i Cili është arkitekti i gjithçkaje të krijuar dhe veçanërisht i familjes, si “qeliza” e shoqërisë njerëzore. “Sot është hedhur poshtë shenjtëria e familjes, vatra e saj u shkatërrua në emër të një lirie, të cilën vetëm një njeri pa arsye mund ta kuptojë dhe kështu bota jonë u mbush me njerëz të ngrirë dhe të vetmuar”, thotë shkrimtari i njohur grek Kosta Ciropulos.

Kërkimet shkencore kanë konstatuar se sëmundja vdekjeprurëse e kancerit fillon kur në trup prishet struktura qelizore. Këtë mund ta themi edhe për trupin e madh

të shoqërisë njerëzore, që në qoftë se qeliza e saj kryesore, familja, ndryshon dhe prish “ADN-në” e saj, atëherë trupi i shoqërisë njerëzore kërcënohet nga një kancer i frikshëm, që me metastazat e tij, shpejtë ose vonë, do e vrasë gjithë njerëzimin.

Pavarësisht se në këtë ditë feste organizohen aktivitete lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe madje thuhet shumë fjalë mbi shëndetin e familjes, barazinë e gruas me burrin, marrëdhëniet prind-fëmijë, uljen e divorceve, përballimin e problemeve sociale, përsëri i shmangemi shkakut kryesor të problemeve të martesës, që siç thamë është sekularizimi, por shmangja e shkakut nuk u jep zgjidhje pasojave.

Prandaj detyra e Kishës Orthodhokse, si shtylla e së vërtetës, është të thotë përsëri dhe përsëri të vërtetën dhe t’u kujtojë brezave në çdo kohë rëndësinë e martesës dhe familjes, si të krijuara këto nga Zoti me qëllim shumë të lartë, si shprehje e dashurisë së Perëndisë për njeriun dhe si pjesëmarrje e njeriut në dashurinë krijuese të Perëndisë. Historia e njerëzimit fillon me një martesë dhe familjen e çiftit të parë, Adamit dhe Evës, dhe do të mbarojë po me një martesë, të Krishtit me nusen e tij, Kishën.

Sipas Shkrimit të Shenjtë, na thuhet: “Perëndia krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së vet, sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë; Ai krijoi mashkullin e femrën. Dhe Perëndia i bekoj; dhe Perëndia u tha atyre: “Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën .” (Zanafilla 1:27-28).

Në doktrinën e krishterë karakteri i ndryshëm seksual i krijuar tek njerëzit ka një rol thelbësor për të luajtur në spiritualitetin njerëzor, që njeriu i bashkuar seksualisht në marrëdhëniet heteroseksuale në martesë, nga dy persona, të bëhen një mish i vetëm dhe nga ky bashkim unik, do të lindin fëmijë që do të formojnë familjen, ashtu siç na e citon Bibla: “Për këtë arsye njeriu do të braktisë babanë dhe nënën e tij dhe do të bashkohet me gruan e tij, dhe do të jenë një mish i vetëm.” (Zanafilla 2:24).

Ashtu si të gjitha gjërat njerëzore nga keqpërdorimi dhe abuzimi mund të prishen dhe degjenerohen, kështu edhe seksualiteti, që është i mirë në vetvete si energji për të krijuar jetën, është bërë sot, në këtë brez të pabesë, më tepër një instrument i mëkatit sesa një mjet për të lavdëruar Perëndinë.

Abuzimet seksuale që dëmtojnë martesën dhe familjen dhe tejkalimi i natyralitetit seksual deri në perversion, kanë si shkak të tyre të drejpërdrejtë, rebelimin e njeriut kundër Perëndisë dhe mohimin e ekzistencës së Tij. “Prandaj edhe i dha Perëndia ata në papastërti me anë të dëshirimeve të zemrave të tyre, që të

shnderohen trupat e atyre në mes tyre, të cilët ndërruan të vërtetën e Perëndisë në gënjeshtëri, edhe nderuan e adhuruan krijesën më tepër se Krijuesin, i cili është i bekuar për gjithë jetën. Amin. Prandaj Perëndia i dha ata në dëshirime shnderimi; sepse edhe femrat e tyre shndërruan marrëdhënien sipas natyrës në atë kundër natyrës. Gjithashtu edhe meshkujt lanë marrëdhënien me femrën sipas natyrës, e u dogjën në dëshirimin e tyre njëri me tjetrin, duke bërë turpe meshkuj me meshkuj, e duke marrë mbi vete shpagimin e duhur të mashtimit të tyre. Edhe si nuk deshën të njohin Perëndinë, Perëndia i dorëzoi ata në mendje të prishur, që të bëjnë ato që nuk janë të hijshme” (Romakëve 1:24-29).

Sipas mësimet të Kishës Orthodhokse, martesë dhe akti seksual i dashurisë bëhet i përsosur vetëm me bekimin e Zotit nëpërmjet Misterit të Martesës në Kishë, prandaj sipas moralit të krishterë, bashkëjetesa pa kurorëzim trajtohet si mëkat dhe marrëdhënie e paligjshme, ose sipas shën Pais Agjoritit: “një inxheksion i djallit që helmon dashurinë e pastër të çiftit dhe i ndan ata njëri nga tjetri”.

Po ashtu, në Krishtërim martesë është monogamike dhe e pandashme, divorci mund të tolerohet vetëm nga mëkati i kurorëshkeljes. Krishti thotë: “Qe shkruar: Kush e lë gruan e tij, le t’i japë letrën e ndarjes”. Por Unë po ju them: Kushdo që përzë gruan e tij, me përjashtim të rastit të kurvërisë, e bënë atë të shkelë kurorën dhe kushdo që martohet me një grua të ndarë, shkel kurorën.” (Mateu 5: 31-32).

Mësimet e Krishtit nxisin çiftin t’i qëndrojnë besnik njëri tjetrit dhe të mos tradhëtojnë as me mendim: “Por unë po ju them se kushdo që shikon një grua për ta dëshiruar, ka shkelur kurorën me të në zemrën e vet.” (Mateu 5:28). Ndërsa apostull Pavli, goja e Krishtit, na thotë: “Martesë të nderohet nga të gjithë dhe shtrati martesor të jetë i pa përlyer, sepse Perëndia do t’i gjykojë kurvarët dhe kurorëshkelësit” (Hebrenjtë 13:4).

Po ashtu Krishtërimi mëson dhe nxit për barazinë e çiftit në martesë, duke e ngritur gruan në pozitë të barabartë me burrin, duke restauruar martesën siç ishte në fillim në çiftin e parë me Adamin dhe Evën, ku sipas Shkrimit të Shenjtë, marrja nga Perëndia e brinjës së Adamit që ishte dhe afër zemrës për të krijuar trupin e Evës, tregon se gruaja ishte e barabartë me burrin dhe e dashur nga burri, por e gjithë kjo barazi dhe dashuri u prish kur Eva gaboi dhe dëgjoi djallin që e nxiti të hante frutin e ndaluar që të bëhej perëndi përpara burrit, por ajo mori mbi veten e saj mallkimin e Zotit dhe tiraninë e burrit: “Gruas i tha: Unë do të shumëzohet në masë të madhe vuajtjet e tua dhe barrët e tua; me vuajtje do të lindësh fëmijë, dëshirat e tua do të drejtohen nga burri yt dhe ai do të sundojë mbi ty” (Zanafilla 3:16). Krishti, i Cili lindi si njeri prej gruas, pa farën e burrit, e hoqi mallkimin e gruas dhe e bëri atë shkak shpëtimi dhe të barabartë me burrin, prandaj thuhet: “nuk ka më

mashkull e femër; sepse ju të gjithë jeni një në Krishtin Jisu” (Galatasve 3:28).

Ky barazim i personave në martesën e krishterë, është një barazi me funksione dhe detyra të ndryshme. Përsëri apostulli Pavli na tregon misterin dhe mënyrën se si duhet të funksionojë barazia në çift, kjo krejt ndryshe nga lëvizjet feministe që promovon një rebelim të grave nga detyrat e saj në familje si grua dhe nënë dhe që është shkak i shumë divorceve që po e trondisin martesën dhe shkatërrojnë familjen. “Ju, gratë, nënshtrojeni burrave tuaj porsì Zotit, sepse burri është kreu i gruas, sikurse edhe Krishti është kreu i kishës, dhe ai vetë është Shpëtimtari i trupit. Ashtu si kisha i është nënshtroar Krishtit, kështu gratë duhet t`u nënshtrohen burrave të tyre në çdo gjë. Ju, burra, t`i doni gratë tuaja, sikurse edhe Krishti ka dashur kishën dhe e ka dhënë veten e vet për të... Kështu burrat duhet t`i duan gratë e veta porsì trupat e tyre; kush do gruan e vet do vetveten. Sepse askush nuk urreu mishin e vet, por e ushqen dhe kujdeset me butësi për të, sikurse edhe Zoti bën me kishën, sepse ne jemi gjymtyrë të trupit të tij, të mishit të tij dhe të kockave të tij. “Prandaj njeriu do të lërë babanë e vet dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet, dhe të dy do të bëhen një mish i vetëm”. Ky mister është i madh; tani unë e them në lidhje me Krishtin dhe me kishën. Por secili nga ju kështu ta dojë gruan e vet sikurse e do veten e vet; dhe po kështu gruaja ta respektojë burrin.” (Efesianet 5:22-33).

Dashuria e trefishtë në martesë (agape=dashura si veprim i mirësisë për hirë të tjetrit, eros=dashuria për hir të bashkimit me tjetrin dhe filia=dashuria e miqësisë me tjetrin), jo vetëm e bashkon çiftin në një, por siç e cituam më sipër, përmbushet në lindjen e fëmijëve. Prandaj ata që dashurohen në të vërtetë në martesë natyralisht do të kenë fëmijë si fryt të dashurisë. Ata që i përçmojnë fëmijët ose i ndalojnë të vijnë në jetë me ndërhyrje, nuk dashurojnë në të vërtetë. Martesa e cila refuzon lindjen e fëmijëve, jo nga shkaqe natyrale apo fatkeqësi, por nga ego dhe rehati-dashje, nuk është një bashkim shpirtëror dhe i bekuar nga Zoti.

Në krishtërim kontrolli i lindjes së fëmijëve, është i lejuar vetëm sipas thelbit të jetës shpirtërore, kur lindja e një fëmije do të sjellë rrezik dhe mundim. Ky vendim merrët para Perëndisë me hidhërim dhe lutje. Në orthodhoksi nuk ka opinion se disa mjete të kontrollit të lindjes së fëmijës janë më të mira se të tjerat. Të gjitha mjetet janë të trishtushme dhe të dhembshme për ata që duhen me të vërtetë.

Aborti që nxit krimin e vrasjes brenda familjes, në Kishën Orthodhokse është absolutisht i dënueshëm dhe konsiderohet njësoj si vrasja dhe kanonet e kishës dënojnë si çiftin ashtu edhe ata që e kryejnë abortin: “Gratë që marrin ilaçe për qëllime abordi dhe ato që marrin helme që vrasin fetusin (foshnjën në barkë), u nështrohen ndëshkimit për vrasësit” (Kanoni 92, Sinodi XI Ekum).

Aborti mund të lejohet vetëm kur rrezikon të vdesë nënën, por sipas Besimit Orthodhoks, një nënë që jep jetën për fëmijën e saj konsiderohet si një shenjtore që do të lavdërohet në Mbretërinë e Perëndisë.

Në familje jeta shpirtërore e dashurisë duhet të kërkohet dhe jetohet sa më e plotë që të jetë e mundur. Kjo do të thotë se çdo anëtar i familjes, prind, fëmijë, vëlla dhe motër, duhet të jetojë për tjetrin: “duke mbajtur barrat e njëri-tjetrit dhe kështu përmbushin ligjin e Krishtit” (Galatasve 6:2).

Çdo fëmijë është një dhuratë e Perëndisë dhe prindërit kanë përgjegjësinë dhe duhet të kujdesen për këtë fëmijë të cilin ua besoi Zoti dhe Ai një ditë do t’u kërkojë llogari në gjyqin e madh. Prandaj prindërit në familje duhet të kujdesen për fëmijët, jo vetëm me dashuri, por edhe drejtësi sipas Zotit, kryesisht me anën e shëmbullit të tyre, ashtu siç apostulli këshillon: “Dhe ju, etër, mos i provokoni për zemërim fëmijët tuaj, por i edukoni në disiplinë edhe në këshillë të Zotit” (Efesianëve 6:4). Por edhe fëmijët apostulli i këshillon: “Fëmijë, bindjuni prindërve tuaj në Zotin, sepse kjo është e drejtë. Ndero atin dhe nënën tënde”, ky është urdhëri i parë me premtim “që të jesh mirë edhe të jetosh gjatë mbi dhé” (Efesianëve 1:3).

Sipas shën Joan Gojartit, shtëpia është një kishë e vogël dhe kështu në këtë kishë të vogël të familjes, çdo anëtar i saj mëson të dojë njëri-tjetrin, duke u drejtuar drejt burimit të dashurisë që është Zoti, sepse: “Perëndia është Dashuri” (1 Joani 4:16), që mbasi të largohet nga kjo jetë dhe familja e tij tokësore, të bashkohet me familjen e madhe të Perëndisë, sepse na thuhet: “Ja tenda e Perëndisë me njerëzit! Dhe ai do të banojë me ta; edhe ata do të jenë populli i tij dhe vetë Perëndia do të jetë bashkë me ta, Perëndia e tyre” (Zbulesa 21:3).

Miron Çako, përgjegjësi i Zyrës Katekizmit të Kryepiskopatës së KOASH-it.